291
.3

BOTIME TË „HYLLI I DRITËS"
SERJE E RE

13

GEORG STADTMUELLER

HISTORIJA SHQIPTARE

në pikëpamje të Kombsís si problemë gjurmimesh

përkthyem nga
Prof. KARL GURAKUQI

SHKODËR — SHTYPSHKROJA „A. GJ. FISHTA" — 1942

A 4D/4
949.65 (045)

BOTIME TË „HYLLI I DRITËS"
SERJE E RÉ
13

GEORG STADTMUELLER

HISTORIJA SHQIPTARE

në pikëpamje të Kombsis si problemë gjurmimesh

përkthyem nga
Prof. KARL GURAKUQI

SHKODER — SHTYPSHKROJA „A. GJ. FISHTA" — 1942

INSTITUTI I LARTE PED.
SHKODER
BIBLIOTEKA
Nr. INV. A/3450
K 88

HISTORIJA SHQIPTARE

në pikëpamje të Kombsís si problemë gjurmimesh

Ndërmjet visevet t' Europës jug-lindore Shqipnija âsht vendi mâ i pa-njoftuni e mbi të cilin janë bâm mâ pak kërkime. Shqipnija gjindet edhe sot në rrethanat mâ të vjetrat mâ tepër se çdo vend tjetër i Ballkanit. Veçimi i saj toksuer e ka përkrahë në nji mënyrë të posaçme ruejtjen e ksaj vjetërsije.

Randsija e Shqipnís nuk qendron vetëm në pasunín e saj të mbrendëshme, në plleshmenín e në visaret e saja toksore, por sidomos në pozitën e saj geopolitike. Këjo pozitë dhe trajtsija e vendit të saj i a kanë paracaktue fatin e zhvillimit historik. Shqipnija gjindet në daljen e Adriatikut, aty ku Ballkani dhe Italija janë shum afër njëni tjetrës, të ndâm vetëm prej përshkimit të rrugës së ngushtë t' Otrantit. Nga këjo gjâ Shqipnija ka nji randsí të madhe si urë kalimi për në Ballkan dhe njikohësisht si drŷ n' Adriatik. Për ketë randsi, çdo fuqi sunduese e këtij deti âsht përpjekë gjithmonë t' a shtijë Shqipnín nën ndikimin e vet (kështu veproi Roma, këso dore bâni Venediku e në ketë mënyrë vepron sot Italija).

Ajo qi përgjithësisht dijmë për historín shqiptare âsht shum gjâ e pakët. Në tansín historike Shqipnija na del në shesh vetëm disa herë; kështu flitet për ndërmarrset ushtarake të Cezarit kundra Pompeut, mâ vonë në meskohë për kryqzatat, pastaj në shekullín 15 për luftimet kreshnike të Shqiptarvet nën prisín e fatosit të tyne kombtár Skanderbeut, i cili e mprojti vendin për dheta vjetësh kundra fuqís së madhe të Turqvet, dhe mâ në fund dijmë edhe se Shqipnija në historín e madhe qe gjithnji molla e grindjes në mes fuqivet kufitare: në meskohë ndërmjet Byzantit, Bullgarís, Venedikut dhe Normanvet; në fillimin e kohës së ré ndërmjet Venedikut dhe Turqvet; përpara Luftës Botnore ndërmjet Italís dhe Austri-Hungarís; mbas kësaj lufte ndërmjet Italís dhe Jugoslavís. Arsyeja pse vetëm me ndërpremje të gjata ndigjojmë ndonji send për historín e Shqipnís âsht pse ky vend nuk ka pasë nji historí të vijueshme politike, mbassi nuk ka gëzuem kurr nji zhvillim të vijueshëm politik. Përkundrazi mund të flasim

shum mirë për historín e kombsís shqíptare, qi âsht shum interesante dhe shum e randësishme.

Popullín shqíptár e njofim qysh prej shekullít XI në drítën e burimevet t' ona, qi na tregojnë historín e tij. Mbi historín e mâparëshme të këtij populli të vogël nuk kemi burime historike. Këso dore për gjurmuesín historík del në shesh pyetja: ç' ka qënë përpara ky popull, ku dhe në çfarë trajtash të jashtëme e të mbrendëshme jetese ka pasë jetue mâ parë ? Ketë pyetje historike na e quejmë me sbprehjen e zakonshme *„çashtje shqíptare"*, krejt njashtu sikurse e kemi zakon b. f. t' a thrrasim fatin historik të parë të popullit rumun me emnin *„çashtje rumune"*.

Gjurmimet e deritashme janë përpjekë për t' i dhânë nji zgjídhje kësaj pyetjeje, por këto kërkime nuk kanë qënë të plota e të hollësishme dhe janë mbështetë mâ tepër në përmbledhje materjali arheologik, gjuhësuer e folkloristík. Në kohën e vjetër kanë qënë sidomos disa udhëtarë dhe *Konsujt e Fuqíve të Mdhá*, të cilët kanë shkruem dhe na kanë lânë vrejtjet e veta qi kanë pasë rasë të mbledhin në pikëpamje historike, gjuhësore dhe folkloristike shqíptare; kështu p. sh. *Johann Georg von Hahn* [1]), konsull austriak për Greqín lindore, *F. C. H. L. Pouquevílle*, konsull i Anglís prap në Janinë, *Theodor A. Ippen*, konsull i Austrís në Shkodër dhe *L. S. Jastrebov*, konsull rus në Prízrend.

* * *

Gjurmimet dítunore mbi gjuhën shqípe u fílluen nga Lelbniz-i, cili edhe në ketë fushë ka ndikuem me shtýtjen e vet. Ky qe qi për herën e parë, i shtym nga njoftëmenija me Shqíptarët, me të cilët i rá rasa të takohej, theksoi randsín e kësaj gjuhe së çudítëshme dhe karakteristike. Mbas këtij drejtimi të veçuem, qe Hans Erich Thunmann-i, profesuer n' Universitetin e Halle-s, qi bâni provën e parë systematike për të na e paraqitë ketë gjuhë e për t' a caktuem këtë në kvadrin e gjuhvet fqinje. Franz Bopp-i, themeluesi i dijtunís krahasuese gjuhësore indogermane, e rreshtoi pastaj gjuhën shqípe në rrethin e dijtunís krahasuese të gjuhvet dhe na provoi se ajo na paraqet nji degë të posaçme mbrenda familjes gjuhësore indogermane. Mâ vonë gjurmimet moderne mbi shqípen në pikëpamje dijtunore janë të lidhuna mâ së pari me emnat e Gustav Meyer-it dhe Gustav

[1]) Ky âsht themeluesi i kërkimevet shkencore mbi Shqípnin. Kryevepra e tij *„Albanesische Studien"*, I.III (Jeva 1854) âsht edhe sot e domosdoshme.

Weigand-it, pastaj me ata të Holger Pedersen-it, H. Barić-it, A M. Seli-çev-it, P. Skok-ut e sidomos me emnin e Norbert Jokl-it, i cili dijti të rrëxojë mendimin e mâparshëm se latinishtja vulgare kishte ndikuem tepër në shqípen, tue e vûm ketë ndikesë në masën qi i përkiste.

Gjithashtu edhe *gjurmimet mbi jetesën, doket dhe zakonet popullore* kanë qënë objekt studimi rreth kësaj Shqípnije mysterjoze pse rrethanat dhe gjendja e vjetër e këtij vendi dhe e këtij populli i kanë dhânë rasën kërkimtarit të lëshojë shikimin e vet në kohën mâ të largtën historike. Asht e vërtetë se këto gjurmime, po i quejmë popullore, të Shqípnís kanë mbetë deri tani të nji - anshme, d. m. th. kufízohen vetëm në viset malsore të Shqípnís së Veriut, kurse krahinat e jugut shqíptár nuk kanë qënë kurr deri sot të kërkueme e të gjurmuemę systematikisht. Gjurmimet systematike të veriut, sidomos t' Alpevet shqíptare veriore e të trollit malcuer të Drinit, janë puna e pa-reshtun e geologut hungarez Franz Nopcsa-s, i cili ka botuem shum vepra mbi këto çashtje. Pranë këtij âsht për t' u përmendë edhe kërkimtari german Arthur Haberland.

Të gjitha gjurmimet e deritashme shqíptare na paraqesin nji pasqyrë të njij specjalizimi shum të madh. Këto u nisen nga shum anë: në pikë pamje historike, arheologike, gjuhësore dhe folkloristike, por mjerisht nuk u muer para sysh prej kërkuj qi të lidhen e të bashkohen gjitha këto rrugë të ndryshme kërkimesh, vezhgimesh dhe vretjesh. Vetëm me anën e njij lidhjeje së tillë do të dilte në shesh pergjegja mbi krejt çashtjen shqíptare.

* * *

Mâ së pari i duhet dhânë përgjegja pyetjes se ku ndodheshin Shqíptarët pesëqind vjet përpara se të dukeshin në histori (XI shekull) [1]) Arsyeja pse gjurmimet e deritashme nuk ,kanë mujtë me e zgjídhë çashtjen e atdheut të Shqíptarvet qendron në mungesat e ndryshme methudike.

1) Deri tani gjíthmonë u rrah kjo çashtje vetëm nga nji anë, sikurse thamë mâ përpara.

2) Çashtja e atdheut u nis me ket formulim të gabuem: *a janë Shqíptarët autoktonë apo jo?* Këjo pyetje nuk âsht aspak me vend,

[1]) Pranë kësaj çashtjeje lozin nji rol shum të madh e mâ të gjânë pyetset mbi *zhvillimin e trupit të njeriut* dhe mbi *zhvillimin e vetëdijes popullore.*

pse nuk mund të flitet kurrsesi për nji autoktonsi absolute. Mund të bisedohet mbi caktimin dhe kufizimin e vend-banimit e të hapsís jetsore të njij populli në nji kohë të caktueme.

3) Gjithashtu âsht nji gabim me rrjedhime të randa trazimi i çashtjes s' atdheut me çashtjen e zanafilles. Këto dy çashtje janë krejt të ndame njëna nga tjetra. Nuk âsht e mundun të nxiret nji përfundim nga atdheu i Shqiptarvet të parë per zanafillen e tyne prej Thrakasvet ase prej Ilirvet, as përkundrazi nuk mund të nxjerrim ndonji përfundim nga zanafilla për të caktuem atdhén.

4). Po ashtu u takue në pengime të forta, ngase u trazue çashtja shqiptare me atë të Rumunvet, d. m. th. me çashtjen e fatit të parë historik të popullit rumun. Asht afër mendësh se për historin e parë shqiptare âsht nevoja të mirret para sysh në mënyrë krahasuese historija rumune, pse problemat e gjurmimevet dhe vështirsit janë të gjashme ndërmjet tyne. Si për njënën ashtu edhe për tjetrën na interesón te ndriçojmë kohën mâ të vjetrën në histori të njij populli me anë burimesh jo të shkrueme, mbassi na mungojnë burimet e shkrueme. Në çashtjen e historis së parë shpiptare dhe rumune na del në shesh se këta dy popuj, si ç' duket, kanë jetuem në nji bashkësí të ngushtë për disa qinda vjetësh gjatë zhvillimit historik të parë të vet; të dy si popuj ravgues barijsh në viset malsore të Ballkanit. Visari i përbashkët i fjalvet në fushën baritore dhe n' atë të rritjes së bagtís na e përforcon ket mendim. Por me gjith këtë, duhet mos t' a trazojmë çashtjen shqiptare me atë rumunen, pse kjo e fundit nuk âsht zgjidhë endè me gjurmimet e deritashme, pse tash gadi dy shekuj dijtunarët e çashtjes rumune janë ndám në dy grumbuj kundërshtarë: antarët e *„thezës së vijimsís"*, të cilët janë të mendimit se Rumunët e soçëm gjinden të vendosun pa ndryshim qysh prej kohës romake në viset e soçme në veri të Danubit të poshtëm — sidomos në Siebenbürgen — dhe antarët e *„thezës s' imigrimit"*, të cilët përkundrazi mprojnë mendimin, se nuk mund të flitet për nji vijimsí vendosje rumune në këto vise, por se Rumunët vetëm në meskohën e shtýme kanë imigruem për në viset e Karpathvet, tue u shpërngulë nga atdheu i parë i tyne, qi duhet të ket qênë në viset malsore të mbrendsís së Ballkanit në lug të Danubit. Këto dy hypotheza janë gjetë dhe gjinden edhe sot në kundërshtim të hapët njëna me tjetrën. Derisa mos të mrrihet në nji ndriçim të vërtetë e të plotë mbi ketë çashtje të randësishme, nuk âsht e mundun të mirret njëna ase tjetra hypothezë si pikë nisjeje për zgjidhjen e çashtjes shqiptare.

* * *

Për kësaj kritike të mungesavet methudike të gjurmimevet të deritashme na del në shesh rruga methudike për zgjidhjen e çashtjes shqiptare. Janë për t' u theksuem tri pika methudike:

1. *Mbledhja e të gjitha burimeve.* Duhen shfrytzuem faktet arheologike, gjuhësore në pikëpamje dijtunore dhe faktori folklorístik, monetat, mbishkrimet dhe prodhimet e pakta letrare.

2. *Mnjanimi í çashtjes së zanafilles dhe í çashtjes rumune.*

3. *Mos-përfillja e autoktonsís.* Qellimi i gjurmimevet âsht të caktojë me të gjitha mjetet qi janë përdoresh, hapsinën jetsore mâ të vjetrën të Shqiptarvet të soçëm. Shprehja *„hapsinë jetsore"* duhet të pelqehet mâ tepër se shprehja *„atdhe"*, pse kjo e dyta na paraqet zakonisht stabilitetín, qi nuk mund t' i përshtatet as kohés së re e aq ma pak kohës së parë shqiptare. Për Shqiptarët e soçëm e për ata të vjetrit nuk mund të flitet për nji hapsinë vendosjeje as për nji tokë kombtare, pse ky populi nuk qe populi katundar, por nji populi barijsh ravgues, gjâ qi mund të vrehet edhe sot në disa vise të tij.

Jeta baritore ravguese âsht nji dukuní e përbashkët ballkanike, nji trajtë ekonomije, qi e kërkon vetë natyra e vendit, d. m. th. rrafshinat e bjeshkvet. Barijt ravgues gjejnë atje nder maja mundësí kullotjeje për grigjët e veta, qi i kanë me shumicë. Në dimën natyrisht këto vende kullotjeje janë të mbulueme me borë, prandej barijt shtërngohen vetvetiu qi këto grigjë t' i zbresin në vjeshtë kah fusha dhe të dimnojnë në sheshet e lumejvet dhe në fushat e brigjevet të Shqipnís s' ultët. Këjo mënyrë jetese e çuditshme shifet edhe sot në Ballkan në disa vise, si b. f. sidomos në Shqipnín veriore, ku dalja në bjeshkë zakonisht ndodhë ditën e Shën Gjergjit (23 Prill) dhe ulja në fushë ditën e Shë Dhimitrit (26 Tetuer). Pra hapsina jetsore e njij populli barituer ravgues qendron në vise kullotjeje verore në rrafshinat e bjeshkvet e në vende kullotjeje dimnore në fusha lumejsh e në sheshe bregore. Ndërmjet këtyne viseve janë pastaj ato vende, nepër të cilat përshkohen tue hypë e tue zbritë nga bjeshka.

Pikën e nisjes së gjurmimevet, caktimi i të cilavet âsht hapsina e parë jetsore e Shqiptarvet, na e jep hapsina e vendbanimit të soçem të popullit shqiptar. Argumentimi do të vijojë në vijë retrogresive. Prandej mâ së pari do të pershkruejmë mirë vend-banimin e soçëm të popullit shqiptar, pastaj ndryshimet e ndryshme të këtij vend-banimi në kohën e kalueme tue u mbështetë në burimet t' ona

historike, e kështu tue vijuem në kohë gjithnji mâ të largta, do të përpiqemi të mrrijmë në kohën e parë shqiptare. Dhe ket atdhé në kohën e parë shqiptare e quejmë na *hapsinë e parë jetsore të Shqiptarvet.* Me anën e këtij caktimi na del për të parën herë nji provë e mirë e historís së kombsís shqiptare. Prej këndej na paraqitet nji pasqyrë krejt e ré e kësaj kombsije. Populli shqiptár del në shesh si nji tepricë e kohës së vjetër ballkanike në mes të romanizimit të përgjithshëm në kohën e soçme. Ketë kohë prandej të sajimit të popullit do t' a quejmë, simbas veshtrimit të drejtë *koha e herëshme shqiptare.* Kohën përpara kësaj do t'a quejmë *koha para-shqiptare,* atë mâ të vonshme do t' a thrrasim *koha e parë shqiptare.* Këso dore na del *periudhizimi i ri i historís së kombsís shqiptare.*

I. **Koha para-shqiptare** (deri po thuej 200 vjetë p. Kr.)

II. **Koha e herëshme shqiptare** (koha e romanizimit: po thuej 200 vjetë p. Kr. deri afër 600 mb. Kr.)

III. **Koha e parë shqiptare** (prej pushtimit sllav të vendit deri te dukja e parë e Shqiptarvet në dritën e historís: po thuej 600 deri afër 1050).

IV. **Koha e përhapjes së madhe të vend-banimit dhe e feudalizimit** (1050-1468).

V. **Koha osmane. Turqizimi. Islamizimi dhe lëvizja e dytë e përhapjes** (1468-1912).

VI. **Koha e shtetit të pamvarshëm** (1912-).

I. Koha para-shqiptare

Shqiptarët janë bashkë me Grekët i vetmi popull i vjetërsís në Ballkan, prej të cilvet nji pakicë mujti të shpëtojë nga romanizimi. Pas-ardhësit e kësaj pakice janë Shqiptarét e soçëm. Burime letrare mbi historín e kohës para-shqiptare nuk gjinden. Gjurmimi prandej duhet të mbështetet sidomos mbi përfundimet e dijtunis gjuhësore. Visari i fjalvet i shqipes së soçme na tregon, se shkalla mâ e para e jetesës së popullit ka qënë jeta baritore ravguese. Duhet t'i kundrojmë Shqiptarët e kohës para-shqiptare sí barij ravgues në mbrendsín e vendit, me kanú fisesh e skotash, me çfaqje besimtare shum të vjetra: me totemizmin, me nderimin e gjarpijvet, me besimin në hyjní natyrore të pa-emën, të cilat na japin të kuptojmë në nji mënyrë fare të kjartë, së Shqiptarët e kohës para-shqiptare nuk kishin mrrijtë endè

në çfaqje hyjnish të personifikueme. Mbassi na në kohën e vjetër në Ballkan njofim dy popuj të mdhaj — Thrakasit dhe Ilirët — na del pyetja se cilit prej këtyne dy popujve i përkitshin të parët e Shqiptarvet të soçëm. Gjurmimet e deritashme nuk kanë dhânë përfundime të preme mbi ketë çashtje të zanafillës së tyne.

Nji ndërmjetsinë të dukshme në zhvillimin para-shqiptar e sajon *Kolonizimi i dytë grek,* i cili zuni fill ne shekullin e VIII dhe për gati tre shekuj me radhë themeloi qytete të lulzueshme tregtare po thuej se në të gjitha brigjet e Mesdheut e të Detitt të Zí. Ky kolonizim nuk ka karakter bujqsuer, por tregtar. Nuk u themeluen koloní, bujqish, por koloní tregtije në vende të pershtatëshme, aty ku rruga tregtare të natyrshme të çojshin në mbrendsín e vendit. Prej këtyne qyteteve tregtare u përhap kultura greke në viset e mbrendëshme barbare; këto të dyja trazohen e shkrihen njëna me tjetrën dhe kështu na del nji kulturë e përzieme greke-barbare, e cila shtrihej gjithkah në hinterlandin e kolonivet greke, kapërcen Shqipnín dhe Bosnjen e mrrijnë deri në Francën jugore dhe në Spanjën lindore. Edhe në krahinat e Shqipnís së soçme kolonizimi grek shkaktoi themelimin e shum qyteteve të randsishme tregtare: midis të tjeravet, *Buthroton* dhe *Phoiniken* në jug, pastaj *Apollonia-n* (afër Vlonë së sotme), mâ vonë *Dyrrachion* (Durrsin e sotëm) e mâ nalt në veri *Nymphaion* (Shën Gjini i soçëm). Në hinterlandin e Apolonis u sajue nji krahinë e lulzueme kulture, e cila na jep nji pasqyrë të të kjartë të kulturës së përzieme greke-barbare të Ballkanit prendimuer: krahina kodrinore e Mallakastrës me qytetet dhe kështjellet e shumta të vetat [1]). Krahas me shkrimjen kulturore u krijue njikohë sisht nji paralel në bazë të kombsís. Vendas barbarë të visevet të mbrendëshme u futën në qytetet greke. Krejt kultura greke në këto vise jashtë botës helenike pësoi nji barbarizim. Pranë Shqiptarvet të kësaj kohe shifet ndikesa greke në mbrendsín e vendit në çashtjen e besimit, por sidomos në kulturën popullore, medje, në disa gjurma edhe në gjuhë.

[1]) Zbulimi mâ i përmendúni rreth kësaj kulture së përzieme janë gërmimet e vorrezavet të Trebenishtit.

II. Koha e herëshme Shqiptare.

Viset e Shqipnís së soçme në kohën prej vjetit 200 deri 100 p. Kr. ranë pak nga pak nën pushtimin romak. Çfaqjen e fundit të këtij pushtimi e dhanë luftimet randsí-plote ndërmjet Cezarit dhe Pompeut, të cilat u zhvilluen në Shqipní e. në krahinat kufitare me të. Në shekullin e parë mb. Kr. nisi për Shqipnin koha e sundimit të qetë e të pa-trazuem romak dhe me këtë filloi romanizmi i saj. [1]) Ndikimi shumë i madh i kulturës romake dhe i gjuhës latine u përhap gjithkah në viset shqiptare; ky ndikim u shtri gjatë rrugvet të mdhá ushtarake, qi Romakët ndertuen gjatë brigjevet deri në gjinin e Shkodrës. Gjatë rrugvet u themeluen qytete romake dhe pranë këtyne kazerma ushtarake *(Canabæ)*, shtëpiza bujqsore *(Villæ)* dhe kështjelle. Të gjitha këto pika mbështetjeje dhe vende banimi u banë qendra nga të cilat dolën rrezet e romanizimit. Administrata romake dhe ushtrija e Romës kanë ndihmuem për përhapien e romanizimit e për zhdukjen e djalektevet të vjetra ballkanike. Romanizimi hyni në mbrendsín e Ballkanit nga dy rrugë, - në njënën anë nga bregu i Adriatikut, n' anën tjetër nga kufini i Danubit, ku gjindeshin fushimet e fuqishme të Legjonevet, çdonjëni prej të cilavet vepronte si qendër romanizimi. Këso dore na del spjegimi i kjartë pse Ballkani u romanizue me kohë në viset e veta bregore në prendim e në veri, kurse në mbrendsín e vendit u ruejt me kambë-ngulje e për nji kohë të gjatë kombsija e vjetër dhe gjuhët e vjetra, dhe natyrisht për nji kohë edhe mâ të gjatë në viset malsore mâ të largtat. Rreth vjetit 300 mb. Kr. u krye përgjithësisht ky romanizim, vetëm në disa vise të mbrendëshme të Ballkanit qindruen ende gjuhët e vjetra ballkanike. Kështu historisht na njofim dy prej këtyne gjuhve, gjuhën e *Bessen-vet* në malet e Rodopit dhe pastaj gjuhen e *Shqiptarvet të hershëm,*

Natyrisht romanizimi nuk e ka kapë krejt Ballkanin, pse në jug ndeshi në hapsinën gjuhësore, popullore, kulturore të Grekvet të vjetër, e cila në kohën e mâvonshme u përhap edhe në veri. Këso dore u ndeshën në periudhën e vonë perandorake në mbrendsín e Ballkanit dy perzimjet e mdhaja gjuhësore dhe kulturore: romanizimi,

[1]) Ngjarja e romanizimit na u ndriçue sidomos nga gjurmimet e bâme prej dijetarvet: Konstantin Jiriçek, Alexandru Philippide dhe Andrea Alföldi. I pari ka studjue e ndriçuem viset sllave në Ballkan, i dyti çashtjen qi ka lidhje me të parën, d. m. th. historin e parë rumune, kurse i treti romanizimin e Panonis.

i cili hyni nga veriu e nga prendimi, dhe greqizimi, i cili vinte nga jugu. U sajue në këtë mënyrë ndërmjet këtyne dy sferave kulture nji *kufi i fortë gjuhësuer latin - grek,* i cili u caktue nga K. Jireçek-u në mbështetje të monetavet, të gurvet të miljevet e t' emnavet të vendevet. Ky kufi gjuhësuer përkon gadi-gadi me kufijt e ndamjes së vjeter krahinore para-djoklecjane.

Në viset malsore qindruen disa gjuhë të vjetra ballkane, shka na mund t' a dishmojmë me dy shembuj. Në shekullin VI dijmë se aso kohe qindronte endè në përdorim gjuha e Bessen-vet, si edhe ajo e Shqiptarvet të hershëm. Asht e dijtun se as këto nuk ngelën krejt të pa-prekuna nga romanizimi i përgjithëshëm; por patën mjaft ndikime, sikurse na dishmojmë sot elementet e shumta latine qi i vrejmë në gjuhën shqipe. Po t' ishte zgjatun ky zhvillim, atëherë gjuha e hershme shqipe mbrenda njij ase dy shekujve do t' i ishte shtrue krejtësisht romanizimit dhe Shqiptarët e soçem do të flitshin nji djalekt romak, qi do t' ishte shum i afërm me gjuhën rumune. Por këjo rrymë e romanizimit u ndërpré menjiherë nga nji vrúll popujsh qi i u turrën vendit: nga *turri sllav.* Rreth vjetit 600 erdhën Sllavët nga ana e përtejme e Danubit dhe pushtuen viset e mbrendshme të Ballkanit. Këta ishin aso kohe nji popull parak katundarësh-druvarë. Përhapjen e vet të madhe nuk i a detyrojnë fuqís së vet politike, por udhëheqjes nga ana e popullit turk nomad-kalorës, Avarvet. Nga vrulli sllav, populsija e vjetër e romanizueme dhe e greqizueme e mbrendsís së Ballkanit iku për në qytetet e brigjevet e nepër ishujt, ku mujti me qindruem nën mprojtjen e flotës mbretnore byzantine, ase u shpërngul nepër male. Fiset e hershme baritore shqiptare, qi ishin në rrezik të romanizoheshin, u shkëputën nga bota e vet romake qi i rrethonte prej dyndjes sllave. Ndikimi i kulturës romake dhe i gjuhës latine u ndalue, dhe kështu i u vu cak romanizimit qi po përparonte në këtë pikë. Gjuha e hershme shqipe ngeli e pa-prekun në këtë kohë ndërmjet këtyne dy rrymave, dhe kështu gjuha e soçme shqipe na paraqet çfaqjen mâ të çuditëshmen dhe të vetmen e njij gjuhe, e cila ka bâm për gjymës zhvillimin e shformimit, tue ngelë prap nji gjuhë në vehte. Këso dore mund të thomi me nji paradoks, se Sllavët u banë shpëtuesit e shqiptarizmës, pse pa pushtimin sllav edhe Shqiptarët e hershëm do të kishin humbë në detin e përgjithëshëm të romanizimit, sikurse të gjitha kombet e vjetra ballkanike.

Çashtja mâ kryesore në gjurmimin e hapsinës së kohës së hershme shqiptare âsht: *gjendja dhe përhapja e hapsinës jetsore shqiptare së hershme.* Ku edhe qysh jetojshin Shqiptarët e hershëm? Dishmín mâ të randsishme për përgjegjen e kësaj pyetjeje na e japin *fjalët latine* qi kanë hŷm në gjuhën shqipe. Gjuha e soçme shqipe mund të thuhet, me nji farë të drejte, se âsht nji gjuhë pjesësisht e romanizueme. Sigurisht shum fjalë janë marrë nga gjuha latine, kështu sidomos ato të farefisnís, shprehjet për çfaqjet e jetës qytetase, të bujqsís, t' organizimit shtetnuer dhe të katundit si vend banimi i përhershëm dhe jo ravgues, pse për ket të fundit kemi fjalë thjesht shqipe. Kjo gjâ na tregon, se mënyra e jetesës së barijvet ravgues qe krejt vendase, kurse bujqsija dhe banimi në nji vend patën ndikesa romake. Shqiptarët e hershëm zunë prej Romakvet edhe rritjen systematike të bletvet. Në kohën para-romake ata mirreshín vetëm me rritjen e bletvet në mënyrë primitive. Edhe disa fjalë pyjesh kanë zanafillë latine. Për t' u theksuem âsht se pylli kënetak i fushës thirret me fjalën latine *„pyll" „padulem" = „paludem."* Kështu edhe fjala *„fushë"* ka rrjedhje latine: *„fusum."*

Pra në fushë Shqiptarët e hershëm u poqën me populisín e romanizueme dhe morën prej kësaj fjalët latine. Përkundrazi nder viset malsore shprehjet e ndryshme për dukunit natyrore janë të lira nga ndikimi latin dhe janë vetem shqipe. Kështu p. sh. janë thjesht shqip fjalët *mal, shpat, bjeshkë.* Nga kjo gjâ nxjerrim perfundimin e arsyeshëm, se Shqiptarët e hershëm si barij ravgues kanë banuem ndër male. Në fushë u poqën me kulturën romake, ku kishin kullosat e veta dimnore.

Prandej edhe shprehja për këto kullosa ka rrjedhje latine: shqip *vrri* = lat. *hiberninum.* Kjo *symbiozë e ngushtë nërmjet Shqiptarvet të hershëm dhe populisís së romanizueme* duket të jet zgjatun për miaft shekuj. Përndryshej nuk mund të spjegohet kjo ndikesë e thellë e kulturës mbretnore romake dhe e gjuhës mbretnore latine. Për këtë arsye duhet të pranojmë se Shqiptarët e hershëm kanë jetue mbrenda mbretnís romake. Me këtë qiten poshtë edhe disa hypotheza të vjetra, të cilat e kërkojnë atdhén e Shqiptarvet jashta mbretnís romake, si b. f. në Siebenbürgen ase edhe deri në Kaukaz.

Në gjuhën shqipe gjinden edhe *disa fjalë* të randsishme *të greqishtes së vjetër.* Këto na dishmojnë, se hapsina jetsore e Shqiptarvet të hershëm duhet kërkuem n' afërsít e kufinit gjuhësuer grek Këso dore përkufizohet hapsina mâ e vjetër jetsore në viset malsore të mbrendsís së Ballkanit. Nji dishmi të vlefshme na japin edhe disa *fjalë dalmatine të vjetra* në fushën kishtare e besimtare, nga të cilat nxiret me të drejtë përfundimi, se Krishtenizimi i Shqiptarvet të vjetër ka rrjedhë prej Dalmatije, prej qendravet të mdhaja kishtare të kësaj krahine. Për këtë pikë nuk âsht nevoja të mendohet për Salonën e largët, por mâ tepër për ndéjën epishkopore të kufinit *Dioclea* (afër Potgoricës së soçme në gjinin e Shkodrës).

Krahina e teprueme e hershme shqiptare mujti me qindruem në mes këtij romanizimi të përgjithëshëm vetëm në nji hapsinë të mbyllun malsore. Në mbështetje pra të këtyne shenimeve të parashtrueme, kjo hapsinë mund të jét vetëm Shqipnija e veriut dhe Serbija e vjetër (Rasha). Kjo e fundit përjashtohet *a priori* nga shqyrtimet e përgjithëshme geografike dhe historike. Serbija e vjetër përbâhet prej visesh qi i ishin të hapuna komunikacjonit, të cilat nuk duhet të cilsohen si vise të mbylluna natyrore. Janë vise të frytshme e mund t' arrihen me lehtësí, qi kanë luejtë nji rol në kohën e vjetër, në të mesmen edhe sot e kësaj dite. Këto, sikurse i kanë vërtetuem zbulimet arheologike të kohvet të reja, kanë pasë gjurma romake të kohës së vjetër të vonë. Kështu pra nuk mbetet tjetër veç t' a kërkojmë hapsinën jetsore të Shqiptarvet të hershëm në viset malsore shqiptare të veriut. Këjo ndahet në tre grumbuj:

1 — *Viset e Alpevet shqiptare të veriut,* të cilat sot quhen prej Shqiptarvet *Malsija* e prej Serbvet *Prokletija.* Kjo Malsi âsht nji masiv i madhnueshëm malesh, i cili âsht i ndërprém me lugina të gjâna e të thella të cilat hapin rrugën per në mbrendsín e vendit. Prandej as ky vend nuk mund të kundrohet në tansín e vet si nji krahinë natyrore krejt e shkëputun nga bota tjetër.

2. — *Viset malsore të Drinit.* Këto janë vende të vështira e pak fort të favorshme për komunikacjone. Por me gjith këtë kanë pasë marrëdhanje me të jashtëm, pse gjinden ndërmjet dy qendrash të mdhá kulturore, në prendim kanë gjinin e Shkodrës dhe në lindje krahinat e vjetra serbe. Çdo rrugë kominikacjoni ndërmjet këtyne dy krahinava të randsishme kulture duhet të përshkohet nepër viset malsore të Drinit. Qysh nga kohët para-historike tërhiqet këtu nji rrugë tregtare, të cilën na e njofim sidomos prej zbulimesh të mone-

tavet. Në kohën romake përshkohej këtu rruga ushtarake prej Shkodre për n' Ulpiana. Edhe këtu gjinden gjurma të shumta rrugësh dhe banimesh romake. Prandej edhe këtu me vështirsí mund të pohohet se ka qênë hapsina jetsore e Shqiptarvet të hershëm. Këso dore pra na ngelë vetëm nji tjetër vend dhe ky âsht:

3. — *Krahina e Matit.* Kjo krahinë malsore, e cila âsht e rrethueme prej maledh shum të nalta, mund të kundrohet si nji vend i shkëputun, pse i ka të gjitha kushtet natyrore per të ngelë në njênë anë. Dhe me të drejtë kjo ka qênë qysh nga kohët e vjetra e deri sot qendra popullore e vërtetë e Shqipnís, qi i ka kundërshtuem ndikimit të huej. Prandej këto kujtime të pergjithëshme na japin *a priori* dishmín se hapsina jetsore shqiptare e hershme ka qênë krahina e Matit. Asht e dijtun se nuk mund të mbështetemi vetëm në vleftën e dishmivet të nxjerruna *a priori;* por âsht nevoja të paraqiten dishmít nji nga nji, të cilat të na vërtetojnë me fakte se kultura romake nuk e ka përfshim krahinën e Matit. Këto dishmí mund të provohen në mbështetje të zbulimevet toksore arheologike dhe të tepricavet t' emnavet latinë.

Sigurisht mâ përpara kanë qênë mâ shum emna latinë vendesh në Shqipnín e soçme veriore, të cilët mâ vonë natyrisht u zhdukën me anën e pushtimit sllav. Janë ruejtë vetëm disa të pakët, por edhe këta kanë marrë trajta tjera nga shqiptími sllav dhe shqip. Këso tepríca emnash latinë gjinden në Shqipnín e poshtme, në viset malsore të Drinit dhe në Serbín e vjetër.

Zbulimet toksore arheologike na çojnë edhe ma përtej. Prej përshkrimevet udhëtimesh e prej zbulimevet arheologike mund të caktojmë *rretín rruguer romak* të kohës së vjetër së vonë. Këto udhëtime dhe zbulime na japin këto vija të mdhaja rrugore:

1). Nga *Scodra* (Shkodra) mbi *Lissus* (Lesh) nepër viset malsore të Drinit për në *Ulpiana* (Lipljan në fushën e Kosovës).

2). Nga *Lissus* mbi *Dyrrachion* (Durrës) për në *Clodiana* (Peqin).

3). E përmenduna *Via Agnatia,* e cila të çonte nepër luginën e Shkuminit për në Liqênin e Ohrit, për në Macedoní e për në Selanik. Në këtë rrugë të madhe, e cila në kohën e vjetër të vonë pati rji randsi të posaçme si lidhje ndërmjet Romës e Konstantinopolit, të çojshim prej Adriatikut dý rrugë të tërthorta nga dy qytetet e mdhá bregdetare, nga Dyrrachion (Durrës) dhe nga Apollonia (afër Vlonës së soçme). Këto dy rrugë bashkoheshin në Clodiana. —

Përveç këtyne rrugve do të kén qênë edhe shum tjera, qi nuk kanë qênë të ndrequna me aq kujdes. Këso dore kemi b. f. gjurmat e njij rruge romake, e cila tue u nisë po thuej se nga Tirana e soçme, të çonte nepër lugun e Krrabës për në krahinën e Elbasanit. Gjithashtu janë gjetë gjurmat e njij rruge tjetër në luginën e Devollit, qellimi i së cilës ishte *Antipatría,* Berati i soçëm. Për plotsimin e këtij rreti rruguer përkojnë edhe gjurmat e shum qyteteve romake katundevet, fushimevet dhe shtëpizavet bujqsore. Edhe në viset e Alpevet shqiptare të veriut gjinden gjurma të lehta romanizimi. Përkundrazi vetëm krahina e Matit duket se ka shpëtuem nga ky romanizím. Së paku deri sot nuk kanë dalë gjurmët arheologike nga koha romane, ndonse edhe kjo krahinë malsore âsht gjurmuem sikurse të gjitha viset tjera kulture romake dhe greke.

Vërtesija e këtij perfundimi del në dritë me anën e njij *drejtimi kulturuer-geografik mbi Shqipnín e mbi viset rreth e për qark saj në kohën e vjetër të vonë.* Përpara së gjithash, zbulimet toksore na japin dishmín se gjini i Shkodrës, ashtu edhe fusha bregore e Shqipnís s' ulët, ishin të hapuna për kulturën romake. Po kjo gjâ do të pohohet edhe për luginën e Shkuminit, e cila përshkohej nga Via Egnatia. Macedonija e vendosun aty afër kah lindja, na çfaqë nji gjendje të çuditëshme: aty gjinden zona të veçueme nën ndikimin romak, kurse prap pranë këtyne gjinden të tjera, qi i kanë shpëtuem romanizimit. Këto të fundit nuk kanë qênë të banueme sí sot dhe kanë qênë përdorë vetém prej barijvet ravgues si vise kullose. Çfarë mase ka pasë romanizimi në këto krahina, mund t' a caktojmë sidomos në mbështetje të mbishkrimevet të vjetra. Këto mbishkrime të shumta na tregojnë, se krahina e Ohrit dhe e Prílepit pat qênë nji rreth grek në pikëpamje gjuhe dhe kombsije, kurse përkundrazi krahina e Shkupit pat qênë nji rreth latin. Viset serbe të vjetra, qi gjindeshin në veri-prendim të krahinës së Shkupit ishin të romanizueme, si Novipazari, Fusha e Kosovës dhe Metohija. Prej këndej u fut ky romanizim edhe në viset e malevet të nalta t' Alpevet shpiptare të veriut, gjâ qi na e dishmojnë disa gjurmë të qendrimit romak. Prej Novipazarit të çonte nji rrugë romake andej në krahinën e Plevljes, e cila ishte si vijë lidhjeje kah veriu me krahinën e kulturës romake në luginën e Drinit, e cila në kohën romake ishte nji vend i lulzuem kulture. Po të shqyrtojmë kartën e këtyne viseve kulture në kohën romake të vonë e në kohën byzantine të parë, do të shofim se ato

sajojshin nji rreth për qark krahinës së Matit. Këso dore na del kjarisht në shesh, se kjo krahinë duhet të kundrohet si hapsina jetsore e Shqiptarvet të hershëm pa përzimje e pa trazime. Ky përfundim provohet mâ në fund prej dy faktesh:

1) Romakët e panë t' arsyeshëm ndërtimin e njij kështjelli të fortë në hymjen e krahinës së Matit në prakun malsuer t' Ungrejt, me qellim qi të mprohej fusha e frytshme e gjinit të Shkodrës nga sulmimet prej krahinës së Matit. Ky vend malsuer para duhet qi mos të két qênë plotsisht i shtruem në kohën rromake.

2) Gjindet nji kartë e krahinavet romake të Ballkanit në nji dorëshkrim të vjetër të Ptolemaios-it (cod. Urbinas, shek. XI), e cila na jep edhe nji dishmi tietër në ket drejtim. Vija e kufinit ndërmjet krahinës romake së vonë *Praevalis* (në pergjithësi Mali i Zi i soçëm dhe krahina e Alpevet veriore shqiptare) dhe *Epirus nova* zgjatet në kartën e Ptolemaios-it prej Lezhes, bri visevet malsore të Drinit, për të gjatë veri-lindjes deri në viset e Serbis së vjetër. Kjo gjâ na tregon pra, se krahina e Matit gjindej jashtë kufinit të krahinës *Praevalis*, prej kah çelet me të vërtetë nji rrugë komunikacjoni në ketë krahinë malcore (mbi prakun malsuer t' Ungrejt). Kështu pra Mati gjindej jashtë krahinës romake, i mjanuem si nji vend politik i kërkuj, sikurse pat qindruem edhe mâ vonë në kohën e sundimit otoman.

III. Koha e parë Shqiptare.

Ngjarja me randsi, qi i prini njij kohe së ré në historin kombtare shqiptare, qe *pushtimi sllav* (rreth 600 mb. kr). N' atë kohë erdhën prej andej Danubit dhe pushtuen viset e lira në mbrendsin e Ballkanit në grumbuj të mdhaj bujqit sllavë nën udhëheqjen politike dhe ushtarake të njij populli kalorës ravgues, Avarvet. Kultura romake u prish krejtsisht në viset e mbrendëshme. Mujti me qindruem vetëm nepër ishujt dhe rrypinat bregore nën mprojtjen e flotës mbretnore byzantine. Për Shqiptarët ky pushtim sllav âsht i randsishëm, pse ndërpreu romanizimin qi po përparonte, dhe bâni qi të qindronte kombsija shqiptare në shkallën e romanizimit të pjesëshëm, në te cilën kishte mrrijtë aso kohë.

Gjurmimet e deritashme të oushtimit sllav u mbështetën per së tepërmi në burime, të cilat na japin vetëm nji pasqyrë jo të plotë të këtij fakti me randsi historije botnore. Në këto burime të shkrueme shofim vetëm disá sulme plaçkitjeje dhe disá ndërmarrje me qellime rrembimi të turmavet sllave. Nuk dijmë kurrgjâ për vendosjen e këtyne bujqve në ket vend, dhe aq mâ pak për marrëdhanjet ndërmjet banorvet të vjetër të romanizuem dhe te ri-ardhunvet sllavë. Në ketë pikë mund të na ndihmojnë vetëm gjurmimet gjuhësore dhe t' emnavet të vendevet. Arheologija nuk mund të na hyjë në punë aspak pse populli parak sllav mirrej vetëm me punimet e drunit, nga të cilat natyrisht nuk ka mujtë të ruhej askurrgjâ.

Pasqyra e ré qi kemi për zhvillimin e pushtimit sllav na paraqet dy valë të mdhá të këtij sulmi. E para valë ngjau në gjymsëm e parë të pshekullit VI. Aso kohe erdhën disa turma të pakta sllav nën udhëheqjen e Kutrigurvet, edhe këta nji popull turk. Këto turma të shërndame nuk e pushtuen vendin, por e plaçkitshin dhe tërë-e shiqeshin me të shejtë përsëri. Kështu pra për tani nuk mund të flitet për nji pushtim të vërtetë sllav. Ky pushtim i detyrohet valës së dytë, kur turmat sllave u sulën me shumicë e të bashkueme, t' udhëheqjuna e t' organizueme nga Avarët. Në bashkim e në lidhje me fuqin politike dhe ushtarake t' Avarvet, mujtën me e shëndrruem krejtsisht kartën kombtare të Ballkanit. Në kohën përpara pushtimit sllav Europa jug-lindore ishte e banueme prej tre popujve:

1. — *Grekët.* Këta banojshin në brigjet e Detit Egjé, të Detit të Zi e të Detit Jon. Prej këndej hyni në kohën e vjetër të vonë greqizimi në mbrendsin e Ballkanit, ku u takue me romanizimin përparues nga veriu e nga prendimi.

2. — *Romakët.* Sikurse u pá mâ përpara, u përhap përpara pushtimit sllav romanizimi mbi krejt gjymsen veriore të gadishullit ballkan, prej Detit Adriatik deri në Detin e Zi. Ky romanizim hyni nga brigjet e Adriatikut dhe nga kufijt e forcuem në Danub.

3. — *Gjermanët.* Këta kishin nën pushtim të vetin të gjitha viset në veri të Danubit.

Kjo pasqyrë e gjendjes kombtare para pushtimit sllav n' Europën jug-lindore mori nji trajtë krejt të ré nga ky pushtim. Germanët u shtynë nga Europa jug-lindore. Grekët u tërhoqen nder brigje, Romakë

INSTITUTI I LARTE PEDAGOG. I
SHKODER
BIBLIOTEKA
Nr. INV. A/3450

pësuen në një pjesë të vogël të njajtin fat, në tjetrën anë qenë shtërnguem të zmbrapën në viset malsore të pa-përshkueshme, ku banorët e romanizuem, të shtŷmë nga nevoja, u banë barij tue e lânë bujqsín. Një pjesë e madhe e këtyne Romakve u shkrî gjatë shekujvet në sllavizëm. Mbi ketë ngjarje nuk kemi drítë të mjaftë, pse historishkruesít byzantinë, të cilët na kanë lânë lajme të sigurta mbi krejt botën, nuk na kanë dhânë aspak ndriçim mbi mbrendsín e Ballkanit. Këjo kohë historike e errët e mbrendsís së Ballkanit zgjatet prej fillimit të shekullit VII deri në shekullin X. Vetëm ripushtimi i këtyne viseve nga ana e fuqís byzantine në luftat e gjymsës së dytë të shekullit X dhe shgatrrimi përfundimtár i mbretnís bullgare në vjetin 1018 na jep prap dritë mbi viset e mbrendsís së Ballkanit.

Pasqyra e ré e gjendjes Kombtare, qi u sajue nga pushtimi sllav dhe qi pastaj qindroi mâ tepër se katër shekuj pa ndonji ndryshim themeluer, na paraqet një *Trini* kombtare dhe shoqnore. Jetojnë tani brî njêni tjetrit tri elemente, secili me një trajtë të pasaçme jetese ekonomike dhe shoqnore:

1. — *Një element qytetar:* në Dalmati Romakët, në viset tjera të brigjevet Grekët.

2. — *Një element katundar:* Sllavët, qi mbajtën nën pushtim të vetin në mbrendsín e vendit të Ballkanit tokët mâ të frytshme të bukës.

3. — *Një element barituer:* Fisat baritore ravguese të Vllehve (Rumunë) dhe Shqiptarët. Pushtimi sllav krijoi një periudhë të ré për popullsín qi pjesërisht ishte e romanizueme. Nga ky pushtim sllav humbi lidhja me kulturën romake qi kishte pasë ngulë rranjë në vend. Për ketë arsye popullsija e këtyne viseve herroi ato qi kishte pasë nxanë në përpjekje me Rromakët në shekujt e kaluem në pikëpamje të parimevet të para të një bujqsije të thieshtë dhe ktheu prap në shkallën e konomike të jetës baritore ravguese.

Hapsina jetsore e Shqiptarvet të parë në shekujt mbas pushtimit sllav mund të caktohet sidomos me anën e *fjalvet sllave* të hŷme në gjuhën shqipe. Kjo gjendje e uhajtjes së fjalvet sllave, e cila u shqyrtue sidomos nga dijetarët rusë Makušev dhe Selišçev, pjestohet në tri ndamje të ndryshme kohe. Ndamja e parë përfshîn kohën e symbjozës (bashkë-jetesës) ndermjet barijvet ravgues shqiptarë të ma-

levet dhe bujqvet sllavë të fushës (shek. VII-X). Ndamja e dytë âsht e kohës kur Shqiptarët ngulën banimet e veta në fushë (shek. XI-XIII). Ndamja e tretë i përket kohës së mbretnís së madhe serbe (shek: XIV). Prej këtyne të trijavet, e para dhe e dyta ndamje janë mâ të randsishmet, e treta përfshîn vetëm një sasi relativisht të vogël fjalësh të marruna nga sllavishtja. Shtresa e parë dhe e dytë janë marrë prej bullgarishtes, kurse e treta prej serbo-kroatishtes. Prej këtij fakti mund të nxiret dishmija, se hapsina *e parë jetsore* shqiptare nuk duhet kërkuem në krahinën e Alpevet veriore të Shqipnís; pse po të kishin banuem atje barijt ravgues shqiptarë, atëherë fjalët sllave do t' i kishin marrë prej serbo-kroatishtes të visevet rreth e për qark. Një tjetër dishmi me randsí për hapsinën jetsore të Shqiptarvet të parë âsht se fjalët mâ të vjetra sllave na çojnë ke djalekti bullgar i Dibrës. Atje pra, në rrjedhën e sipërme të Drinit të Zi, do të két ngjám përpjekja mâ e vjetër në mes të Shqiptarvet të parë dhe të Sllavëvet dhe qi duhet të jét prej kohës së fillimit të pushtimit sllav. Të randsishëm janë pastaj emnat sllavë të pemvet e të vendevet, qi kanë hŷm në gjuhën shqipe. Këta na tregojnë se Shqiptarët e parë kanë pasë zanë vend në viset malsore, kurse Sllavët përkundrazi në krahinat e brigjevet e në fushat. Kështu shum fjalë bimësh janë sllave. Përkundrazi emnat e bimvet dhe të visevet në botën malsore janë thjesht shqip. Fjalët e marruna nga sllavishtja nga japin dritë edhe mbi bashkë-jetesën kulturore ndërmjet këtyne dy popujve. Sllavët u dhanë Shqiptarvet të parë orendi e vëgla për shtepi e per oborr.

Prej të gjitha këtynë fakteve gjuhësore mund të nxjerrin përfundimin e gjithmbarshëm, se Shqiptarët e parë kanë pasë banuem në viset malsore n' afërsít e Dibrës. Ky përfundim vërtetohet pastaj edhe *prej përhapjes s' emnavet sllavë vendesh.* Shqipnija jugore dhe Shqipnija e poshtme kanë një sasí të madhe emnash sllavë vendesh. Edhe krahina e Alpevet veriore shqiptare, ashtu edhe ajo e Drinit kanë disa emna të tillë. Përkundrazi krahina e Matit ka mbetë mjaft, e pastër. Në mbështetje të këtyne emnave vendesh, mund të përfundohet, se Sllavët u futën përpjetë Drinit dhe pushtuen viset malsore t' asaj ane. Edhe në krahinën e Matit erdhën disa grumbuj të pakët sllavë përpjetë lumit dhe zunë vend në luginën e tij.

Edhe *gjendja toksore politike edhe kishtare* na e vërtetojnë ket perfundim. Krahina e Matit gjindej në shekuj mbas pushtimit sllav në mes të shtetevet të mdhá, Byzantit, Bullgaris dhe Princnís

serbe të Dioklitjes. Por nuk kemi vërtetime në se qe inkvadruem në ndonjënin prej këtyne shteteve. Gjithkështu qindron puna në pikëpamje të jurisdikconit kishtar. Për të gjitha krahinat rreth e përqark kemi lajme për selit epishkopore në meskohën e parë, kurse për krahinën e Matit nuk kemi asnji njoftim. Këso dore pra të gjitha gjurmimet e deritashme na e bijnë krahinën e Matit si hapsinën jetsore të Shqiptarvet të parë. Gjithashtu edhe natyra e mnijanueme e kjësa krahine malsore na e perforcon ket përfundim.

IV. Koha e përhapjes së madhe të vend-banimit dhe e feudalizmit (1050-1468).

Të rrethuem e të ngujuem ndërmjet tri Fuqivet të mdhaja kufitare — Serbís, Byzantit e Bullgarís — Shqiptarët e parë nuk luejtën prej vendit. Vetëm në çasin, kur u shgatrrue rregullimi politik i këtij rrethi, i shofim prap këta barij ravgues shqiptarë. Kur në vjetin 1018 gjeti shgatrrimin e vet mbretnija e madhe bullgare mbas shuplakavet të randa nga ushtrít byzantine, nisi menjiherë — mbas vdekjes së perandorit Basileos II 41025) — nji farë shrregullimi i rendit politik në viset malsore macedone-shqiptare. Me këtë mrrijti *ora historike e fisevet luftarake-baritore shqiptare.*

Gjymsa e shekullit prej vjetit 1025 deri 1081 qe për historin e mbrendëshme byzantine nji periudhë anarkije. Perandorë të ligësht nuk qenë në shkallë të mbajshin në dorë drejtimin e Shtetit, dhe shpesh herë qenë lodra në duert e princeshavet lakmimtare. Shembërnit në mes të burokratís qytetare dhe ushtrís e dobsuen forcën e mbrendëshme të mbretnís. Burokratija i a doli qi të mnjanonte statutin e vjetër themeltar, qi tash sa shekuj kishte pasë sajuem themelet ushtarake të mbretnís. Këso dore vendit i u hapën dyert për sulmime të jashtëme, pa qënë i zoti t' u bânte báll. Ndërsa mbrenda shtetit gjindeshin në grindje partít e ndryshme, u rras mbrendë anmiku i jashtëm në prendim e në lindje. Në krahinat kufitare mbretnonte nji kaos, shum generala u përpoqën në mendje të vet, të ndihmuem nga ushtarët, për të ndaluem shgatrrimin e mbretnís. Andej këndej u ngjallën disa kryengritje të vogla dhe në këto u dukën për të parën herë Shqiptarët tue marrë pjesë në luftimet e generalavet kryengritës. Kjo pjesëmarrje âsht karakteristike per Shqip-

tarët në shekujt qi vijuen, d. m. th. ata luftuen si mercenarë. Kur në vjetin 1081 hypi në fron përsëri nji peranduer i zoti (Aleksi I), Shqiptarvet i u desht të rrijshin urtë në punën e vet. Dhe kjo gjendje vijoi për nji shekull. Vetëm në kohën kur mbretnija nisi prap të shgatrrohej, dhe kjo gjâ ngjau ndërmjet vjetvet 1180 dhe 1204, Shqiptarët përfituen prej kësaj rase për të dalë përsëri në shesh.

Kur pastaj u shkatrrue mbretnija lindore romake nën shtytjen e Kryqtarís IV (1204) dhe kështu u shkaktue nji kaos shtetesh së vogla, atëherë erdhi prap nji orë e përshtatshme për kombsín shqiptare. Tani fillon përhapja e saj e madhe, mâ së pari me pushtimet luftarake. Në fillím kjo përhapje u shtrî në viset kodrinore, qi gjinden pranë krahinës së Matit, d. m. th. në Tiranë e Krujë, pastaj në Shqipnín e mesme jugore; kjo ngjau në shekullin XIII. Luftarët barij shqiptarë u futën në këto vise si pushtues dhe nënshtruen, tue u bâm pronarë tokësh, banorët sllavë të ngulun aty. Në ketë gjendje shoqnore dhe politike u zhvillue nji kulturë e çuditshme feudale. *Feudalizimi i Ballkanit,* qi âsht nji karakteristikë e posaçme e shekullit XIII, pushtoi edhe Shqipnín. Ky feudalizem hŷni pastaj në nji trajtë mâ të shtrembnueme e mâ t' egër në mbrendsín malsore, në daç si styl i jashtëm jete, në daç si përmbajtje e mbrendëshme.

Prej kësaj hapsine të vend-banimit të rí të Shqiptarvet në shekullin XIII vijoi përhapja në njënë anë kah veri-lindja për në viset e Serbís së vjetër e n' anën tjetër kah jugu për n' Epir e për në Greqín e mesme. Sundimi i Anjous-vet në Shqipnín e poshtme (i ashtu-quejtuni *«regnum Albaniae")* nuk u bâ shkak për nji lidhje politike të krahinavet shqiptare. Kjo lidhje u bâ punë e kryeme vetëm në mbretnín e madhe serbe të Stefan Dushanit të IV (1331-1355). Ky krijoi prap nji rregullim politik dhe nji qetsí të madhe, tue i [illegible] një ikohësisht përhapjes anarhike të fisevet luftare-baritore shqiptare. Me shkatrrimin e kësaj mbretnije, mbas vdekjes së Stefan Dushanit (1355), nisi prap nji përhapje e ré shqiptare. Kjo pati dy drejtime të mdhaja:

1) — Për në veri-lindje. Këtu u pushtuen viset e Serbís së vjetër dhe nji pjesë e madhe e Macedonís veriore dhe prendimore. Këtu Shqiptarët ngelën si nënshtresë, kurse mbi-shtresa mbeti serbe.

2). — Për në jug. Për këndej u drejtue sulmi kryesuer i përhapjes shqiptare. Shqiptarët pushtuen Epirin, Akarnanín dhe Etolín., Atje u pjestue rryma e përhapjes. Njëna pjesë u sul për në Beotí, Atikë, Nekropont dhe për n' ishujt; tjetra pjesë shkoi nepërmes gjinit

të Korinthit për në Moré, ku u pushtuen prej Shqiptarvet vise të hapta, sidomos në Morén lindore. Aso kohe në Greqí ziente një shpírt kolonizimi krejt ashtu sikurse ngjau në kohën e kolonizimit të vendevet nga ana e Germanvet. Shqiptarët erdhën në këtë periudhën e dytë të perhapjes së vet jo vetëm si pushtues me forcë, por edhe mbas grishjes së pronarvet të vogjël tokësh, të cilët e dishrojshin ardhjen e këtij populli të ri. Përfundimi i kësaj dyndjeje së madhe jugore të Shqiptarvet qe pushtimi i njíj pjese së madhe të tokës kombtare të Grekvet të rij. [1])

Kjo përhapje e madhe shqiptare u ndalue mandej nga shkaku i pushtimit turk. Në vjetin 1389 u shgatrrue fuqija e përparshme serbe me fitimin turk në Fushën e Kosovës. Asht e vërtetë se thyemja turke afër Ankarës kundra Mongolvet (1402) i vûni cak një herë përhapjes së fuqís osmane, por pastaj fitimet turke nuk patën má ndalim. Në fillimin e shekullit XV gadi krejt Ballkani u bâ turk, vetëm pak vise për rreth e ruejtën vetëqeverimin, *sidomos Greqija, Shqipnija, Bosnja.*

Edhe Shpipnija pak nga pak u bâ turke. Kundërshtimi shqiptar nuk qindroi má në Shqipnín e mesme dhe jugore, dhe kështu popullsija e këtyne viseve u shpërngul me shumicë për n' Italín jugore e për në Sicilí, ku atëherë u sajuen kolonit e mdhá shqiptare, të cilat qindrojnë edhe sot. Por edhe një herë Shqiptarët u bashkuen dhe banë një qindresë të madhe kundra Turqvet. Shqiptari i Veriut *Gjergj Kastrioti* (Skandërbegu) mori përsipër udhëheqjen e kësaj lufte për liri.

Si njoftës i mirë i mënyrës turke të luftimit — kishte pasë kaluem vjetët e parë të rinís si peng pranë Turqvet — mujti, i mprojtun nga natyra e fortë e vendit malsuer të Shqipnís veriore, me i kundërshtuem për 25 vjetë me radhë fuqís shum herë má të madhe turke (1443-1468). Turqit nuk mujtën kurr me e pushtuem vendin e tij të forcuem, fortesën ndër shkrepa, Krujën. Asht e dijtun se Skandërbeu kishte pasë siguruem mprojtjen politike të mbretnís së Napolit dhe përpiqej të siguronte edhe mprojtjen e fuqís detare, Venedikut. Kjo kohë e luftavet të Skandërbeut kundra Turqvet qe pe-

[1]) Në këtë mënyrë kombi shqiptar pati një pjesë përfunduese në formimin e popullit të Grekvet të rij. Má vonë këta Shqiptarë u greqízuen, jo nga shkaku i një veprimi systematik nga ana greke, por sidomos nga shkaku i sipranis kulturore greke, e cila shdrejtazi ndikonte mbi kishë e shkollë.

riudha kreshnike e vërtetë e historís shqiptare. Në këtë kohë doli për herën e parë një histori shqipe: *Marin Barleti,* një Shqiptar nga Shkodra, shkroi historín e Shqiptarvet, tue zanë fill nga luftat e Skandërbeut. Si një humanist i vërtetë e lidhi këtë histori në një mënyrë të vjetrueme me historín epirote dhe macedonase të vjetërsís. [1])

V. Koha osmane, turqizimi, islamizimi dhe lëvizja e dytë e përhapjes (1468-1912).

Kur në vjetin 1468 Skandërbeu vdiq në Lesh, mori fund kundërshtimi i Shqiptarvet kundra Turqvet. Tani krejt Shqipnija u bâ turke. Mbassi shum Shqiptarë liri-dashës nuk deshtën me i u shtruem sundimit turk, ngjau një *dyndje e madhe për n' Italín e poshtme e për në Sicilí,* ku t' ikunit shqiptarë patën si dhuratë vend-banime të reja. Në fillim Italija pati mjaft të çame kreje me të shpërngulunit shqiptarë. Qytetet italjane qenë shtërnguem me marrë masa kundra këtyne elementeve turbulluese, dhe një shkrimtar i asaj kohe na i përshkruen si *„gente malcontenta e sempre ribellante".* Por pak nga pak Shqiptari u mësue me një gjendje të qetë dhe u bâ një element i besueshëm në jetën shtetnore. I pajisun me cilsí të mdhá, i dha jetës shtetnore dhe kulturore fuqí të vlefshme për përparim. Mos të harrohet, se Shqiptarët patën një randsí të madhe n' ushtrín napolitane dhe venedikase. Politika ushtarake venedikase e zgjânimit duhet t' i a dije edhe shpërnguljes shqiptare në Dalmatí e n' Istrí.

Sundimi turk me të vërtetë i dha fund përhapjes së vend-banimit shqiptar, por nuk mujt me ndaluem rolin historik të shqiptarizmës. Madje edhe në mbretnín osmane Shqiptarët patën randsí të madhe, e cila u zhvillue, si gjithnji, me të njajtën methudhë. Për të kuptuem historín kombtare shqiptare në mbretnín osmane, duhen pasë para sysh má së pari vijat themelore të së drejtës islame të pakicavet. Kjo e drejtë islame e pakicavet nuk rrjedh nga pikëpamja e kombsivet, sikurse kuptohet sot, por nga pikëpamja e besimevet.

Populsija e mbretnís ndahet në dy klasë të mdhaja, qi kanë të drejta krejt të ndryshme njêna nga tjetra: — 1. *Klasa e zotnijvet:* muslimët, të cilët vetëm këta kanë të drejta politike dhe mund

[1]) Krahaso tani Francesco Pall, *„Marino Barlezio; Uno storico umanista".* Bukuresht 1938. (Nxjerrë nga: „Mélanges d' histoire generale" 2 (Cluj 1938).

të mbajnë armë. — 2. *Nënklasa:* jo-muslimët, qi paguejnë taksa. Bujarija e vjetër ballkanike menjiherë mbas pushtimit turk u bâ islame, d. m. th. *„u turqizue“*. Populli i vogël e mbajti për nji kohë mâ të gjatë krishtënimin. Në Shqipni filloi islamizimi i turmavet vetëm në mbarimin e shekullit XVI. Preëj ksaj kohe pak nga pak u islamizuen fise dhe katunde të tana. Në fillimin e shekullit XVII ky islamizim ishte në zhvillim e sipër në Shqipnín veriore e të mesme katholike. [1]) Në shum relacjone e në shum vizita baritore t' asaj kohe thuhet shpesh herë në nji trajtë të stereotypueme në numrimin e katundevet: *„tutti turchi“* apo *„Quasi tutti turchi“*. Ky kthim i vijueshem i populsis n' islamizëm, qi u zgjat në Shqipni deri në Luftën Botnore, nuk âsht për t' u kundruem si nji lëvizje besimtare. Në ketë pikë janë të gjith shkrimtarët të njij mendimi. Arsyet e këtij kthimi ishin të jashtëme, politike dhe ekonomike. Përpara çdo gjâje, me anën e islamizimit kërkohej lirimi nga taksat dhe sigurimi i mprojtjes policore t'auktoritetevet turke [2]).

[1]) Ket fakt e shofim të kjartë nga raporti i vizitatorit apostolik, krye-epishkopit të Tivarit, Marin Bizzi-t, të vjetit 1610.

[1]) Nji rasë me randsí, se si disa krahina mbarë u banë muhamedane per arsye e shkaqe të jashtme, na e difton **F. C. H. L. Pouqueville**, *Voyage dans la Grèce*. I. (Paris 1820), fq. 206-208: Krahina e Karamuratadës në lugun e mesem të Vijosës, kah lindja e Permetit, njehte 36 katunde të banueme prej Shqiptarësh orthodoks, të cillat si famulli i perkitshin deri në vj. 1760 peshkopit të Pojanit, qi ishte nji Sufragan e kryepeshkopit të Beratit. Por, mbasi këto katunde pësuen pada vuejtje të padurueshme prej ndrydhjevet e plaçkavet të të Shqiptarvet muhamedanë të Permetit, të Leskovikut e të Kolonjes, dán të gjitha këto katunde kah fillimi i vjetit 1760 qi 40 ditët e krezhemvet të Pashkvet t' i mbajshin sa mâ shternguesheim, por mandej po kje s' do të vite prej ndokah kurrnji ndihmë e dukshme deri diten e Pashkvet, të braktisshin besimin orthodoks e të mirrshin besimin muhamedan t' anmiqvet të vet, kështuqi t' u vêjshin fund së pakut ndrydhjevet të padame. E, kur erdh e dielija e Pashkvet pa pasë ndihmen e dishrueme, qiten jashtë popat e vet e disa familje të pakta, qi ruejten besimin e vjeter, çuen e thirren prej Permetit nji Kadí e Imam, para të cillvet ndërruen besimin e u bânë muhamedan.

Fill mbas kësaj ngjarje muerën të gjitha uhât e veta kundra atynve, qi i kishin salvue e ndrydhë deri atëherë. Pa kursye kurr i' send dogjën e poqën krahinën e Permetit, të Leskovikut e të Kolonjes. Të gjith burrat kjén mbytë, grât e fëmit kjén shitë si robë. Kur u muer vesht se shka bânë këta tue mbytë e tue plaçkitë, u bashkuen me ta prej mbarë Shqipnije edhe shum shokë tjerë, qi dojshin me bâ plaçkë. Ketë krahinë e dreshtën të gjitha tjerat per rreth deri në kohen e Ali Pashës, qi e nenshtrou.

Nga këto arsye të jashtëme t' islamizimit shifet se zakonisht ky turqizim bâhej sa për faqe. Në zêmër ngelshin prap të krishtênë. Ndiqshin zakonet e krishtênimit, ndërsa për jashta mbaheshin si muslimanë. Në disa vise ka ngjâm, qi prej njij familjeje vetëm kryetari âsht bâm musliman, me qellim qi të kishte vendin qi i përkiste para auktoritetevet turke. Këto rrethana të çuditëshme e çuen gjendjen në *synkretizëm besimtarë*. Pikëpamjet dhe zakonet e dy besimeve u trazuen dhe u shkrinë njéni me tjetrën. Kjo gjâ shifet kjarisht në kultin e shejtënvet. Shejtnorë të vjetër të krishtênë u nderuen vijanos prej atyne qi u kthyen n' islamizëm, dhe kështu kemi të tillë shejtën qi nderohen bashkarisht nga të dyja besimet. Gojëdhanavet të krishtêna shejtnorësh u dhanë kuptime muslimanë. Të krishtênë e muhamedanë bâjshin bashkarisht shtegtime fetare ndër shejtnoret e vendit. Nji fenomen tjetër i islamizimit dhe i synkretizmit besimtar qe përparimi i sektavet muhamedane. Shqiptarët e islamizuem ruejtën aq shum pikëpamje dhe zakone të krishtêna, sa qi nuk e ndiejshin vehten të qetë n' islamin zyrtar dhe kështu u futën në sektat e ndryshme islame, të cilat paraqitshin nji kompromis ndërmjet islamit dhe krishtênimit. Mbi të gjitha qe sekta e Bektashivet, e cila u përhap shum në Shqipni; bektashizmi qe nji fuqí e madhe në ket vend dhe âsht edhe sot e kësaj dite. Islamizimi rroku sidomos viset e vend-banimevet të reja të Shqiptarvet: Serbín e vjetër, Macedonín prendimore, Shqipnín e mesme dhe të jugut. Përkundrazi islami hyni shum ngadalë në viset malsore të Shqipnís së veriut. Fiset e Shqipnís veriore rrijshin larg ndikesavet të hueja nga shkaku i vrazhtësisë vendit. Edhe politikisht mujtën me e ruejtë vetësundimin praktik. Vetëm formalisht e njoftën sipranín e Sulltanit. Por Turqit u panë të shtërnguem t' i mprojshin fushat e frytshme nga sulmet e pandame të këtyne fiseve malsore me anë stacjonesh ushtarake. Elementet e tjera shqiptare, qi banuen në viset e ulta të Shqipnís ase në vend-banimet e reja të Serbís së vjetër e të Macedonís, u kthyen në fén islame dhe kështu, të mprojtun nga auktoritetet turke, shqiptarizmi u përhap jashtëzakonisht edhe nji herë në shekullin XVII. Kjo qe *përhapja e dytë e madhe e vend-banimit të Shqiptarvet*. Drejtimi u muer sidomos për në veri-lindje, mbrendë në Serbín e vjëtër, ku Metohija, Fusha e Kosovës dhe Novipazari u banë krahina shqiptare.

Pranë kësaj përhapjeje vend-banimesh, kemi në kohën osmane edhe nji tjetër përhapje në nji trajtë të jashtëme qi nuk bjen fort në sy: *krijimi i kolonivet ushtarake „arnaute“* gjithkund nepër mbret-

nin e hapët osmane, nga Ukraina deri n' Egjypt dhe n' Afrikën verore. Për hir të zotsís së tyne ushtarake qi e kanë në gjak, Shqiptarët i dhanë mbretnís osmane ushtarët mâ të mirët gjatë shum shekujësh. Islamizmi u çeli Shqiptarvet rrugën politike në mbretnín osmane. Qysh prej kësaj kohe, pra qysh prej fillimit të shekullit XVI, filluen Shqiptarët të kishin nji randsi gjithnji mâ të madhe n' ushtrí dhe në shtet, dhe pak nga pak të bâheshin nji komb i dytë zotnues i mbretnís osmane. Në trupin e Jeniçervet, qi ishte mezja e ushtrís osmane, Shqiptarët qenë elementi mâ i randsishmi, por edhe në trupat e tjerë të mbretnís ata kishin nji vend të dalluem. Edhe shum generala dhe burra shteti të përmendun u shquen në mbretnín osmane, si p. sh. në shekullin XVI e XVII familja e kryeministravet të Qypërlivet, të cilët mujtën me vendosë nji restaurim të përkohëshëm të mbretnís; në shekullin XVIII e XIX dynastija e pashallarvet Bushatlí në Shkodër, të cillët e mbajtën vetëqeverimin n' at qytet gadi nji shekull kundra fuqís qendrore osmane [1]); pastaj Ali Pasha i Janinës dhe Mehmed Aliu i Egjyptit; në shekullin XX Izet Pasha.

Në *Greqí* shqiptarizmi në kohën osmane pati nji randsi edhe mâ të madhe. Lufta greke për lirí (1821-1829) nuk mund të mendohet pa elementin shqíptar. Shqiptarët u dalluen në ketë luftë baras si Grekët, madje Shqiptarët luftuen nga të dyja anët, të krishtenët n' anën greke dhe muhamedanët n' anën turke. Mâ vonë, në shekullin XIX, Shqiptarët e Greqís pak nga pak u greqizuen, mâ së pari me anën e kishës orthodhokse dhe të shkollës. Greqizimi hŷni deri në krahinat shqíptare t' Epirit veriuer, dhe gjithkund, mund të thomi se gjuha greke u përdor nga intelektualët dhe në shpresat kulturore. Gjuha greke u bâ gjuhë marrëdhanjeje së përgjithëshme dhe kulture deri te lugina e Shkumbinit. Në ketë mënyrë greqizimi gjuhësuer, kulturuer dhe kishtar u bâ për Shqiptarët, sikurse edhe për Bullgarët e Rumunët, nji problemë e randë.

Ndrrimet politike qysh prej fillimit të shekullit XIX ngjallën *vetëdijen politike të popullit shqíptar.* Kur në vjetin 1878, në mbështetje të vendimit të Fuqivet të Mdhá, do t' i dorzoheshin Malit të Zi fiset shqíptare të veriut, Hoti e Gruda, atëherë u bashkuen

[1]) Krahaso Jov. N. Tomiç *„Mahmud Bushatlija, pasha skadarski".* Prva period njegova rada (1784-1786). Në „Glas Srpske Kraljevske Akademije" 76 1908), fq. 101-212.

këto fise *në Lidhjen e Prizrendit,* për t' i kundërshtuem këtij coptimi të vendit. Kushtrimi i fisevet shqíptare i shkaktoi ushtrís malazeze luften e përmendun te *Ura e Rrzhanicës,* të cilën e ka kënduem në *„Lahuta e Malsís"* poeti kombtar shqíptar Gjergj Fishta.

Themelimi i Lidhjes së Prizrendit qe e para çfaqje e madhe e vetëdijes kombtare shqíptare. Aso kohe për herën e parë u formuluen kërkesat kombtare të Shqiptarvet. Flamuri i Nacjonalizmit të ri të Shqipnís u zhvillue kryesisht prej dy grupeve të vogla fetare, në njënë anë prej fisevet malsore të veriut, n' anën tjetër prej Bektashivet të përhapun sidomos në Shqípnín jugore e të mesme.

Çashtja besimtare luejti nji rol të madh në historín shqíptare, mbassi besimi dhe vetëdija politike mvareshin prej njënit e tjetrës. Me anën e islamizimit dhe me anën e përhapjes s' orthodhoksís nga ana e Greqís, populli shqíptar në kohën e ré u nda në tri klasa të ndryshme. Kështu lindi çashtja, se nga cila anë do të jipej shtytja për krijimin e njíj kombi politik. Mungonte nji vetëdije politike e përbashkët. Muhamedanët e ndiejshin vehten si mprojtsít e islamit e të sundimit osman, orthodhoksët ishin grekë ase kishin ndiesí greke. Ndjeksít e traditavet të vjetra paraturke ishin vetëm fiset malsore të Shqipnís së veriut, qi kishin mbetë endè katholikë, të cilat ruejshin gjojëdhanat e Skandërbeut, qi përndryshej do t' ishin zhdukun krejt. Vetëdija kombtare pastaj u ndez edhe mâ tepër dhe u shëndrrue në mëni të fortë kundra Malazezvet dhe Grekvet.

VI. Koha e shtetit të pa-mvarshëm (1912 —).

Lufta e Ballkanit e vjetit 1912 shkaktoi *humbje visesh të kombsís shqíptare, të cílat i muerën Serbija dhe Greqija,* por edhe *krijimin e njíj Shteti vetëqeverimtar shqíptar,* natyrisht për hir të Fuqivet të Mdha. Mbas pushtimit të vendit nga ushtrít austro-hungare gjatë Luftës së Madhe dhe mbas disa grindjeve të mbrendëshme, u mëkamb nji Shtet, i cíli rá krejt nën influencën italjane dhë në prendverën e vjetit 1939 qe futë në perandorí fashiste nën trajtën e njíj bashkimi me të drejta shtetnore.

Kjo përmbledhje e historís së popullit shqíptar na jep njikohësisht nji pasqyrë të problemavet të kombsivet ballkanike përgjithësisht.

Pse shkallët e mdhá të zhvillimit të gjith këtyne popujve janë në përgjithësi të njinjishme: *romanizim, pushtim sllav, feudalizim, sundim turk, zgjim i nacjonalizmit.* — Shqipnija âsht zemra e Ballkanit. Këtu kryqzohen të gjitha rrethet e kulturës, qi patën ndikesë në shndrrimin e Ballkanit. Këtu piqen, bashkohen dhe shkrihen të gjitha lëviziet kulturore. Prandej prej Shqipnije mund të njifen mâ së miri të gjitha këto lëvizje. [1]) Shqipnija âsht me të vertetë pika e Arhimedit, prej kah na mund të rrokim problemat gjurmuese të krejt Ballkanit. Historija kombtare shqiptare, vijat e përgjithshme të së cilës i pamë në ket studim, na ndriçon mbi krejt botën rreth e për qark të popujvet e të vendevet të ndryshme të gadishullit ballkanik.

1. — *Mbretnija romake (byzantine) e lindjes.* Mendimi i rrêmë mbi historín romake të lindjes na e paraqet këtë si nji shtet pa fuqi të mbrendëshme, i cili a *priori* u gjykue të shgatrrohej me doemos. Faktet historike e rrxojnë ket mendim të gabuem. Po si spjegohet në vetëdijen t' onë të përgjithëshme historike ky mendim i gabuem, qi vijon gjithnji ? Kjo spjegohet nga se dy histori-shkrues të permendun - Gibbon-i dhe Fallmerayer-i - kanë dijtë me zotsín e vet letrare të na paraqesin nji pasqyrë tërheqse të historís së kësaj mbretnije, ku arti i shkrimit i a mbushë mendjen lexuesit për vërtetsín e thânjevet. Përveç kësaj, gjurmimet e deritashme historike kanë qênë të nji-anshme, d. m. th. janë marrë vetëm me gjendjen e kryeqytetit të shkelqyeshëm, me Konstantinopolin, tue lânë krejt në njênë anë gjendjen nepër krahinat e mbretnís. Për ketë mungesë u mvishet faji jo vetëm gjurmimevet moderne të historís, por edhe gjendjes së keqe të burimevet për mesjetën byzantine. Edhe historija zyrtare e Byzantinvet nuk na jep aq shum lajme mbi krahinat, kurse mbi gjendje dhe ngjarjet e kryeqytetit na jep njoftime gjânë e gjatë. Përkundrazi letërsija hagjografike na shpjen drejt për së drejti në krahinat dhe mirret gjânsisht me jetën e popullit të vogël. Mendimi i gabuem mbi historín e Romës lindore mund të ndreqet tue studjuem popujt për rreth, si b. f. Shqiptarët. Historija e kombsís shqiptare mundet me na treguem se fuqija romake e lindjes ka krijuem dhe siguruem rendin politik në Ballkan, dhe se shgatrrimi i saj në shekullin XI e pastaj prap në shekullin XIII ka shkaktuem nji anarhí të plotë.

[1]) Shum mirë e pat çfaqë ket mendim gjurmuesi i përmendun i Shqipnís Dr. Milan von Sufflay me këto fjalë: „Μονάς, *in qua tamquam in speculo totius peninsulæ Hæmi cernitur* κόσμος".

2) — *Greqizmi.* Gjurmimet mbi historín e kombsís shqiptare të mesjetës së vonë e të kohës së ré na japin nji ndihmë të domosdoshme e të randsishme për historín e krijimit të popullit të rí grek, pse ky popull, sikurse u tha mâ përpara, përbâhet në pjesën kryesore prej Shqiptarësh, të cillët nga shkaku i sípranís kulturore të Grekvet, u greqizuen gjatë shekujvet.

3). — *Symbjoza shqiptare-bullgare në mesjetën e parë.* Dihet, se çfarë roli kanë luejtë Bullgarët si ndërmjetës në mënyrën e zanjes vend e të bujqsís për barijt ravgues të vjetër të Ballkanit — për Shqiptarët e për Rumunët. Njikohësisht ndriçohet edhe përhapja e dikurshme e Bullgarvet deri në Detin Adriatik dhe Jon. Shqipnija jugore dhe ajo e mesmja qenë deri në shekullin XIII vise banimi Bullgarësh. Pastaj pak nga pak kjo populisí katundare bullgare e këtyne viseve u shkrí në shtresë zotnijsh shqiptarë.

4). — *Symbjoza shqiptare-serbe në mesjetën e vonë dhe në kohën e ré.* Ndërmjet Shqiptarvet dhe Serbvet qindron nji symbjozë e ngushtë kulturore qysh prej shekullit XIV, d. m. th. qysh atëherë kur turma shqiptare barijsh zunë vend në viset e Serbís së vjetër dhe i banë këto si vend kombsije shqiptare, kështu qi sot vendi qi historija e njef me emnin Serbi e vjetër mund të quhet mâ me shum arsye *Shqipní e Ré.* Kjo symbjozë shqiptare-serbe u bâ pastaj edhe mâ e ngushtë në Mal të Zi. Fise malazeze dhe shqiptare janë të lidhuna aq ngusht për kah gjaku, sa qi në disa fise shpesh herë nuk jemi në gjendje të dijmë se çfarë gjuhe kanë folë në kohët e para. Si në njênën ashtu edhe në tjetrën rasë mundeni madje edhe t' a dishmojmë se gjinden fise qi e kanë ndrruem kombsín e vet.

5). — *Mbretnija osmane dhe Islami.* Randsija qi Shqiptarët kanë pasë si zotnues të dytë kombtarë të mbretnís osmane në shtet e n' ushtrí, na dishmon se gjurmimet mbi historín e kombsis shqiptare të kohës turke janë nji kusht i domosdoshëm për të kuptuem historín e mbretnís osmane.

6). — *Rumunët.* Për historín rumune paraqitja e ré e historís së kombsís shqiptare âsht jashtëzakonisht e randsishme; pse të gjitha gjurmimet e historís së parë rumune, qi sillen rreth s' ashtu-quejtunes *„çashtje rumune"*, janë të lidhuna ngusht me gjurmimet e historis së parë shqiptare. Në ketë fushë, ku objektiviteti i gjurmimevet qysh në fillim u përdhos nga prirjet shoviniste të politikës së ditës, mu-

ndet me na ndihmuem vetëm ndriçimi i historís së parë shqiptar e; pse fakti kryesuer e qendruer i historís së parë rumune âsht symbjoza ndërmjet Rumunvet dhe Shqiptarvet. Deri sot nuk qe e mundun të zgidhej kjo problemë, pse hapsina jetsore e parë ashtu edhe ajo e hershmja shqiptare ishte e pa njoftun. Por, mbassi tani u ndriçue kjo çashtje, âsht punë e lehtë të gjëjmë nji pikë nisjeje të sigurtë për ndriçimin e çashtjes rumune.

INSTITUTI I LARTE PEDAGOGJIK
SHKODER
BIBLIOTEKA